

VENDIM
Nr. 504, datë 10.9.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 531, DATË 7.9.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE SHTETËRORE ‘OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA’ SHA, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË VEÇANTA TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 105 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. “OBP” sh.a., është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimeve për mallra, punë, shërbime, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur me vendim të Këshillit të Ministrave është përcaktuar ndryshe.”.

c) Pika 11 shfuqizohet.

ç) Pika 11/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11/1. Bëjnë përjashtim nga parashikimet e pikës 5 të këtij vendimi institucionet, që realizojnë vetë procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, si më poshtë vijon:

a) Shtypshkronjat e letrave me vlerë;

b) Shërbimi Informativ i Shtetit.”.

d) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Vullnetarisht, me kërkesë të autoriteteve/enteve kontraktore, “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., mund të pranojë dhe të zhvillojë procedura prokurimi në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, në përputhje me nevojat specifike të autoritetit/entit përfitues, si dhe procedura prokurimi për institucione të tjera publike dhe jopublike, të cilat nuk janë subjekte të këtij vendimi.”.

dh) Pika 12/2 shfuqizohet.

2. Çdo procedurë, që nuk është shpallur në sistemin e prokurimit elektronik deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, dërgohet për t’u zhvilluar pranë “Operatorit të Blerjeve të Përqendruara” sh.a.

3. Vendimi nr. 603, datë 13.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të spitaleve publike, për disa mallra”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., dhe institucionet shtetërore/entet publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama